

Dita botërore e sigurisë dhe shëndetit në punë



**Organizata
Internacionale
e Punës**

ILO ka vendosur 28 prillin si Ditën Botërore të sigurisë dhe shëndetit në punë për promovimin e parandalimit të aksidenteve dhe sëmundjeve të lidhura me vendin e punës

28 prilli dita botërore e sigurisë dhe shëndetit në punë- një fushatë ndërgjegjësimi me qëllim përqendrimin e vëmendjes ndërkombëtare mbi tendencat e reja në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë si dhe rëndësinë e problemeve të lidhura me lëndimet, sëmundjet dhe vdekjet në mbarë botën.


28 prilli është gjithashtu një ditë, në të cilën sindikatat në botë përkujtojnë dhe nderojnë kujtimin e viktimave të aksidenteve dhe sëmundjeve në punë.

Dita Botërore për sigurinë dhe shëndetin në punë është një pjesë integrale e Strategjisë Globale mbi Sigurinë dhe Shëndetin në Punë e drejtuar nga ILO, e cila promovon krijimin e një sigurie globale parandaluese dhe të një kulture shëndetësore me përfshirjen e të gjithë aktorëve.

Në këtë datë, në shumë vende të botës, autoritetet kombëtare, sindikatat, organizatat e sigurisë dhe të shëndetit në punë dhe punëdhënësit, organizojnë aktivitete të shumta.

Tema për Ditën Botërore për sigurinë dhe shëndetin në punë në vitin **2013** është:

Të punojmë së bashku për parandalimin e risqeve



Çfarë është Siguria dhe shëndeti në punë?

Siguria dhe shëndeti në punë janë masat parandaluese të marra që kanë si synim përmirësimin e kushteve gjatë procesit të punës, ruajtjen e jetës, integritetin e shëndetit, mbrojtjen fizike dhe mendore të punëmarrësve që përfshihen në procesin e prodhimit.

Objektivat e shëndetit në punë synojnë:

- 1- Në promovimin dhe mirëmbajtjen në nivel të lartë të mirëqënies fizike, mendore dhe sociale të punonjësve në të gjithë profesionet.
- 2- Në parandalimin e sëmundjeve që vijnë si pasojë e kushteve të punës së punonjësve.
- 3- Në mbrojtjen e punëtorëve nga rreziqet që rrjedhin nga faktorë të dëmshëm për shëndetin në lidhje me punën.
- 4- Në dhënien e një pune të përshtatëshme për çdo punëmarrës, që i përshtatet aftësive të tij fiziologjike dhe psikologjike *“Përshtatje e vendit të punës me punëmarësin dhe punëdhënësin me vendin e tij të punës”*

Përse janë të rëndësishme siguria dhe shëndeti në punë?

Sipas statistikave çdo vit në Bashkimin Europian, më shumë se 5500 njerëz humbin jetën e tyre si pasojë e aksidenteve në vendin e punës.

Është shumë e vështirë që të përcaktosh ndikimin e sëmundjeve profesionale ndaj shëndetit dhe për këtë çështje nuk ka asnjë konsensus të të dhënave. Megjithatë, vlerësimet e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) sugjerojnë se 159 000 njerëz në BE çdo vit vdesin si rezultat i sëmundjeve profesionale.

Kompani të ndryshme në vende të BE-së, humbin rreth 143 milionë ditë pune çdo vit nga aksidentet në punë. Vlerësimet janë të ndryshme, por aksidente të tilla dhe shëndeti i keq i kushtojnë ekonomisë së BE-së të paktën 490 miliard Euro në vit.

Parashikimi i risqeve, zbatimi i masave efektive të sigurisë dhe ndjekja në vazhdimësi me rigorozitet e tyre janë të rëndësishme për reduktimin e këtyre shifrave (EU-OSHA Vende Pune të shëndetëshme 2012-13).

Çdo vit, më shumë se dy milion gra dhe burra vdesin si rezultat i aksidenteve dhe sëmundjeve të lidhura me vendin e punës. Punëtorët vuajnë afërsisht një humbje prej 270

milion euro çdo vit të lidhura me aksidentet dhe 160,000,000 të tjera të lidhura me incidentet dhe sëmundjet po në vendin e punës.

Substanca të rrezikshme vrasin 440.000 punëtorë në vit – asbesti merr 100.000 jetë në vit. Një punëtor vdes çdo 15 sekonda në mbarë botën. 6.000 punëtorë vdesin çdo ditë. Më shumë njerëz vdesin në vendin e punës krahasuar me ata të vrarë në luftëra.

"Është e pamundur që të arrihet siguri absolute në punë. Është jashtëzakonisht e rëndësishme të parandalohet"

"Parandalimi është më i mirë se kurimi"

Parandalimi është themeli i qasjes Europiane ndaj problemeve të sigurisë dhe të shëndetit në punë. Në praktikë, kjo do të thotë që të analizohen proceset e punës për të identifikuar risqet afatgjata dhe afatshkurtëra, dhe më pas të veprohet për ti shmangur ose për ti zbutur ato sa më shumë të jetë e mundur.

Parandalimi i dëmtimeve dhe sëmundjeve nga rreziqet e shëndetit në punë bazohet në dy koncepte bazë:



- 1- Mjedisin në punë dhe teknologjinë prodhuese duhet të projektohen në mënyrë që rreziqet për shëndetin të evidentohen ose minimizohen në minimum.
- 2- Punonjësit duhet të njohin rreziqet në vendin e punës, të trajtohen, edukohen, ndërgjegjësohen që të sillen në mënyrë të sigurt e të përdorin pajisjet mbrojtëse personale në punë.

Përvoja e shumë vendeve të botës ka treguar se fokusimi në përmirësimin e mjedisit të punës dhe shmangia e rreziqeve në punë është më tepër se sa thjeshtë të thyesh punonjësve që të jenë të kojdeshëm.

NJË MJEDIS PUNE / SHËNDETSHËM DHE / SIGURT MBROJ SHËNDETIN DHE JETEN TUAJ